



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Diskutimi ne lidhje me koncesionet

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Xhavit Bushaj, Reme Lala, Eljo Hysko, Vullnet Sinaj, Edlira Hyseni, Krenar Ryçi, Artur Roshi, Korab Lita, Suzana Topi

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Senida Mesi, Ylli Shehu.

Të ftuar:

Znj. Anila Denaj, Minister,

Z. Elton Haxhi, Zv/Minister,

Znj. Mimoza Dhembli, Drejtor I Pergjithshem, Drejtoria e Pergjithshme e Buxhetit,

Z. Gentian Opre, Drejtor, Drejtoria e Pergjithshme e Buxhetit,

Znj. Alda Klosi, Drejtor, Drejtoria e Koncensioneve/PPP

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Sot kemi diskutim për buxhetin e vitit 2020 në lidhje me koncesionet.

Të ftuar janë ministrja e Financave, zonja Alina Denaj, zëvendësministri Elton Haxhi.

Nuk e shoh drejtorin e buxhetit dhe personin përgjegjës zotin Gentian Opre për koncesionet dhe zonjën Alda Klosi, gjithashtu.

Unë mendoj të ecim me një prezantim të ministres dhe pastaj, nëse ka pyetje, komente ose qëndrime.

Urdhëroni, zonja Ministre!

Anila Denaj - Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Në këtë seancë të dedikuar çështjeve që kanë lidhje me koncesionet dhe kontratat e partneritetit publik - privat dëshiroj të diskutoj për atë çfarë parashikon ligji organik i buxhetit.

Së pari, po citoj nenin 4/2 të tij ku përcaktohet se shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontratat koncesionare apo partneriteti publik- privat, si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor.

Së dyti, në po këtë nen përcaktohet se Kuvendi në ligjin vjetor të buxhetit miraton tavanin e vlerës totale të kontratave në përqindje të produktit të brendshëm bruto për të gjithë projekte koncesionare ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishtas gjatë vitit buxhetor korent.

Këtë citim e bëj për të vijuar edhe më tej me raportimin se si është respektuar ky ligj organik ndaj temës së kontratave koncesionare në projektbuxhetin e vitit 2020, ku qartazi kufiri prej 5% i të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës, i vitit 2019, respektohet dukshëm pasi kap një shifër prej 3,3% të këtij totali.

Nëse do të shkojmë akoma dhe më tej me parashikimet përtej këtij viti, do të shikoni në relacion se pagesat për vitet 2021 dhe 2022 kapin vlerat respektive 3,3 dhe 3% të tavanit buxhetor.

Sa i përket nenit tjetër, nenit 19 të projektligjit të buxhetit 2019, përcaktohet se tavani për vlerën totale të kontratave në përqindje të produktit të brendshëm bruto për të gjitha koncesionet, PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishtazi për vitin 2019, në përputhje me të dhënat e regjistrit të koncesioneve është 37,3% e produktit të brendshëm bruto.

Lista e kontratave koncesionare, PPP, në relacionin e buxhetit i referohet kësaj vlere në terma reale dhe është riparë në dy aspekte:

-mospërfshirjen e projekteve PPP, të cilësuar si oferta të pakërkuara, pasi ndryshimet e fondit të ligjit “Për koncesionet dhe partneritetin publik- privat” e përjashtojnë këtë formë propozimi, si dhe për të gjithë kontratat koncesionare PPP, me mbështetje buxhetore, është përdorur vlera totale e specifikuar në kontratë, duke i shtuar edhe vlerën e TVSH-së.

Vlen të theksohet se gjatë procesit të rivlerësimit të projekteve koncesionare, PPP nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, vëmendje e veçantë i është kushtuar testit nëse këto projekte llogariten brenda apo jashtë stokut të Borxhit Publik.

Deri në këtë moment të gjitha projektet koncesionare, PPP, të shqyrtuara nga ana e MFE-së kanë rezultuar jashtë bilancit të qeverisë, duke qenë se, sipas standardeve të ESA 95, pjesa më e madhe e risqeve të lidhura me projektin koncesionar, PPP i mbart sektori privat, në mënyrë të veçantë riskun e ndërtimit dhe atë të disponueshmërisë.

Pavarësisht kësaj, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka një rol gjithnjë e më të madh monitorues, sa i përket kontratave koncesionare, PPP, me qëllim respektimin e rregullave fiskale dhe minimizimin apo eliminimin e risqeve që implikojnë buxhetin.

Në kuadër të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies lidhur me koncesionet, PPP, theksoj se MFE, bazuar në raportimet periodike, takimeve të zhvilluara me përfaqësues të Autoriteteve Kontraktore dhe me asistencën teknike të BB-së, ka finalizuar raportin paraprak të përmbledhur të monitorimit të kontratave koncesionare, PPP, ku prezantohet një pamje e përgjithshme e situatës së kontratave koncesionare/PPP në vend, i cili do të publikohet së shpejti.

Gjithashtu, MFE-ja do të përfundojë së shpejti përgatitjen e tre projektvendimeve që burojnë si detyrim i amendimeve të bëra në muajin shtator 2019, të ligjit 125/2013 dhe konkretisht: projektvendimin “Për organizmin dhe funksionimin e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve”, projektvendimin “Për miratimin e rregullave për mënyrën e funksionimit të Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesioneve” dhe projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr.575, datë 10.7.2013 i KM-së për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion “Për koncesionet dhe partneritetin publik- privat”, i ndryshuar””. Këto akte do të shërbejnë për të përcaktuar rregullat të detajuara në lidhje me funksionimin e Komitetit të Përzgjedhjes të Projekteve të Koncesionit, PPP.

Këto janë të gjitha detyrime ligjore, për të cilat MEF-ja është në projekt zbatimi në vijim.

Ne jemi të hapur për çdo pyetje që mund të keni.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

A ka pyetje?

Urdhëroni, zoti Roshi!

Artur Roshi – Zonja Ministre,

Ju dëgjova me vëmendje. Kjo është temë që tërheq vëmendjen e gjithë qytetarëve shqiptarë, jo thjesht për mjegullën politike që gjoja opozita ka bërë për PPP-të, por vijmë të gjërat konkrete.

Cili është efekti i këtyre PPP-ve që ju financoni? A mund ta financoni ju një projekt, pavarësisht se është edhe përgjegjësi kryesore e ministrisë së linjës, kur juve nuk ju kthen në buxhetin e shtetit investimin e bërë dhe për sa kohë duhet ta kthejë këtë investim të bërë? A keni bërë ju ndonjë plan për një x rrugë (po marrim për shembull rrugën Milot-Balldren)? Cili është efekti që mund të japë në ekonomi? A ndonjë lloj prioriteti? Pse nuk bëhet një aks tjetër, por financohet pikërisht kjo rrugë (për shembull)?

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zonja Ministre, përgjigjuni pyetjeve një nga një!

Anila Denaj – Çdo projekt ka një studim fizibiliteti. Autoriteti kontraktor, i cili menaxhon dhe analizon projektin e fizibilitetit e ka këtë përgjegjësi. Në raport me vënien në dispozicion të kësaj analize fizibiliteti ne do të mundohemi të marrim gjithë këtë analizë dhe ta sjellim në vëmendjen tuaj.

Besoj që në gjykimin e rolit të MEF-së për të ruajtur tavanet buxhetore, për të ruajtur të gjitha risqet fiskale që mund të rrjedhin nga kontrata të tilla, analiza e fizibilitetit është një analizë e cila diskutohet në një kontekst më të gjerë dhe me të dhëna, të cilat sot nuk i kemi këtu, do t'ua sigurojmë edhe për rrugën Milot – Balldren, edhe për çdo PPP tjetër.

Në listën e të gjitha PPP-ve, të cilat mbartin mbështetje buxhetore, numërojmë 14 të tilla nga të cilat 2 janë format. Të gjitha parashikimet e të gjitha vleftave, të cilat brenda vitit nuk e kalojnë vlerën e 3,3%, pra të gjithë vleftën e buxhetuar brenda tavanëve të tyre, besoj se janë një vlerë që konsiderohet në respekt të ligjit që MEF-ja ruan.

Sigurisht, ka risqe fiskale, por ky është një proces i cili mirëmbahet në mënyrë të vazhdueshme në marrëdhënien e drejtpërdrejt me autoritetet kontraktore. Kthimi i çdo investimi shikohet në dy formate, në vlerën e parasë së investuar, sikurse edhe në projektin e investimit.

Një projekt investimi në infrastrukturë sjell një zhvillim ekonomik. Një projekt investimi në përmirësimin e cilësisë së shërbimit, sigurisht, sjell përmirësimin dhe cilësinë e shërbimit. Vlerën në secilën prej tyre ne do t'ua vëmë në dispozicion sa të marrim këtë informacion për secilën nga këto PPP.

Arben Ahmetaj – Kam një sqarim përtej sqarimit që dha ministrja Denaj. Në aspektin se si zgjidhet një projekt, bëtë pyetjen ju, theksoj se një projekt ka zanafillën në ligj me dy mënyra:

E para është ofertë e pakërkuar, ku sektori privat bën hapin e parë dhe prezanton një projekt;

E dyta është oferta e kërkuar, ku, praktikisht, ministria e linjës (qeveria nëpërmjet ministrisë së linjës) bën hapin e parë dhe kërkon.

Dua të sqaroj për qytetarët se të dyja kalojnë në proces tenderimi, sepse ka pasur një tymnajë që këtu është bërë pa tenderim e të tjera e të tjera. Jo. Të dyja kalojnë në procedurën e tenderimit. Pa marr rastin kur bëhet oferta e pakërkuar, ku kushdo ka bërë tymnajë. Në respekt të pyetjes suaj, zoti Roshi, me të drejtë dhe në legjitimitetin tuaj dhe për të sqaruar qytetarët, kur ka një ofertë të pakërkuar, autoriteti përgjegjës që është Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë, në rastin konkret, e merr e studion dhe në analizën brenda institucionit vendos ta pranojë si kërkesë.

Në momentin që e pranon si kërkesë, e pronëson. Ai propozim i pakërkuar kalon në filtrat e ministrisë, thirret propozuesi që të pyetet apo të bëjë ndryshime, në bazë të ligjit se ligji ia jep të drejtën ministrisë. Pra, vjen projekti, pronësohet dhe në momentin që pronësohet, pra bëhet pronë e Ministrisë së Infrastrukturës në rastin konkret, meqenëse e mora si shembull, në këtë moment, në bazë të ligjit, kompania apo përfaqësuesi merr bonusit nga 0-10 pikë dhe atë moment ministria e dërgon për ta filtrua në institucionet specifike. Për shembull, për një rrugë merret dosja dhe çohet te Autoriteti Kombëtar i Rrugëve dhe ky jep gjykimin teknik. Të gjitha çmimet janë në bazë të manualit (këtë mund ta verifikoni, keni të drejtën tuaj legjitime).

Artur Roshi – Dakord si procedurë, por s’po shoh tender. Tenderi ku është?

Arben Ahmetaj – Autoriteti i Rrugëve përgjigjet zyrtarisht për çmimet apo për cilësinë, standardin e rrugëve? Asnjë çmim nuk është mbi manualin. Në këtë moment hidhet në tender, pra përgatiten termat e prokurimit, çohet dosja te APP-ja, aty ku bëhen të gjitha.

Zonja drejtoreshë, besoj se e ndiqni procedurën që e bëni vetë, jo ju, por autoriteti kontraktor.

Aty garohet, hapet për këdo në bazë të termave dhe marrin pjesë 1, 2 apo 10, por këtë nuk e përcakton dot autoriteti kontraktor, është tender i hapur. Pra, mund të marrë pjesë çdokush. Ai që ka bërë ofertën e pakërkuar ka bonusin. Bonusi mund të jetë nga 0-10, mund të jetë 6 apo 7, por e gjykon autoriteti, i cili e vendos bonusin me VKM. Kjo është

shumë e rëndësishme. Pasi bëhet tenderi, del fituesi dhe vazhdon e gjithë logjika e negociatës.

Artur Roshi - Si ka mundësi që në tender merr pjesë vetëm ai që bën ofertën e pakërkuar?

Arben Ahmetaj - Më fal!

Po bëj një hap mbrapa për të sqaruar pyetjen legjitime dhe të drejtë që bëtë: pse vendoset x rrugë dhe jo y rrugë? Ka dy momente shumë të rëndësishme në procedurë. Hapi i parë është kur ministri përgjegjës që përfaqëson autoritetin e mundshëm kontraktor shkon në Komitetin e Investimeve Strategjike dhe përballë një grupi të madh ministrash me përjashtime të vogla, është të paktën 70 % e kabinetit, bën prezantimin e saj dhe thotë: “Kam këtë ofertë të pakërkuar ose të kërkuar, kam këto argumente për rrugën, konektivitetin, prekjen e popullsisë pozitivisht nga rruga, shpejtësinë e tregtisë e të tjera, sepse projekti publik në kuptimin e shifrave nuk ka të njëjtën logjikë me projektin privat. Kur bën dikush një fabrikë, me atë kur shteti bën një rrugë. Kthimi i investimit numërohet në rritjen e sektorit, në përmirësimin e tregtisë, në përmirësimin e konektivitetit, në aksesin e popullatës në shërbim e të tjera. Nuk po u hyj të gjithave, për të mos ju marrë kohë.

Artur Roshi – Pyetja ime është kjo: mund të jetë një aks tjetër që të japë impakt më të madh në ekonomi?

Arben Ahmetaj - Po, është shumë e vërtetë, mund të jetë. Pyetja juaj është e saktë. Në Këshillin e Investimeve bëhet një debat. Po e bëj në formë ushtrimi, kur silltet një rrugë, dikush tjetër nga ministrat ose vetë Kryeministri mund të thotë: “Pse kjo rrugë dhe jo ajo”.

Artur Roshi - Për sa kohë kthehet investimi?

Arben Ahmetaj - Kthehet me zhvillimin ekonomik. Nëse e ke zhvillimin ekonomik 4,1%, atëherë kthimi është më i shpejtë, nëse e ke 2%, kthimi është më i ngadaltë.

Artur Roshi - Kthehet për 30 ose 40 vjet.

Arben Ahmetaj - Do vij edhe tek ajo. E kam për qytetarët. Ju më ndihmuat me pyetjen tuaj shumë të saktë. Momenti që vendoset në Këshillin e Investimeve se ky projekt do të merret në konsideratë, që Ministria e Financave të fillojë ta marrë parasysh (pastaj do të them se çfarë bën Ministria e Financave) do të duhet të kalojë në PBA, të futet në buxhetin afatmesëm. Aty, Ministria e Financave bën një ushtrim që në buxhetin afatmesëm e shikon përtej 3 vjetëve, për shembull në ministri ka ushtrime, të cilat shkojnë deri në vitin 2027 të PPP-ve për të mbajtur të pacenuar atë koncept fiskal që kemi futur në ligjin organik të buxhetit: 5%-shin që financimi i PPP-ve të mos kalojë kurrë 5%-shin e të ardhurave tatimore.

Artur Roshi – Por nuk do të thotë gjë për ekonominë në tërësi për projektet që vijnë ky 5%-shi.

Arben Ahmetaj - E rëndësishme është procedura.

Ju lutem, vetëm mos u mërzitni! E kam me ju miqësisht, por edhe me qytetarët, sepse ka shumë tymnajë.

Dikush thotë, se çmimet janë kështu, dikush tjetër puet: pse nuk është bërë tender? Me të drejtë ju pyesni: “Pse kjo rrugë dhe jo ajo rrugë?”. Është pyetje legjitime. Prandaj po e bëj pak më të gjatë sqarimin e pyetjes suaj. Në momentin që futet në PBA, Ministria e Financave pret që t’i vijë fizibiliteti. Te fizibiliteti Ministria e Fe ka të kufizuar detyrimisht me ligj që t’i referohet fizibilitetit në bazë të qëndrueshmërisë fiskale. Ministria e Financave nuk është autoritet kontraktor. Ministria e Financave e gjykon nëse e mban kurrizi buxhetin apo jo?

Në respekt të pyetjes suaj, ne i kemi thënë jo Rrugës së Arbrit, propozimit të kinezëve, sepse ishte 636 milionë euro, ishte shumë i shtrenjtë dhe nuk bëhej dot. Ishte kundër interesit publik. Shprehja ime, e ish-ministrit Haxhinasto dhe e Kryeministrit ishte: “E refuzojmë, sepse nuk përfaqëson interesat e...”

Artur Roshi - Kinezët i morët për aeroportin.

Arben Ahmetaj - Mos i ngatërro gjërat!

Zoti Rroshi, mos më ndërprisni!

Në rastin e Rrugës së Arbrit, propozimi i kinezëve 636 milionë euro, ishte përtej çdo mundësie buxhetore dhe interesi publik. Kryeministri bashkë me mua dhe ish-ministrin Haxhinasto u ka referuar atyre se është në kundërshtim me interesin publik dhe me interesin e Republikës së Shqipërisë.

Propozimi i parë i aeroportit të Vlorës, pse u rrëzua nga ish -ministri për Infrastrukturën dhe nga ish -ministri i Financave në atë kohë?

Artur Roshi - U tërhoq investitori.

Arben Ahmetaj - Jo! Nuk e dini të vërtetën. Kontraktori i mundshëm, propozuesi i mundshëm presupozonte që të hidhte më pak se çfarë do të hidhte buxheti i shtetit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Roshi dëgjo se të intereson, sepse ti je gjysmë nga Vlora dhe gjysmë nga Gjirokastra.

Artur Roshi- Po, më intereson shumë edhe po të jem nga Kukësi.

Arben Ahmetaj – Koncesionari i mundshëm sillte propozimin që afatgjatë buxheti i shtetit nëpërmjet garantimit të trafikut paguante më shumë sesa paguante aksione, pra kapital të drejtpërdrejtë koncesionari. Iu kthye përgjigje negative. Po vazhdoj logjikën.

Artur Roshi - Ato që lanë PPP-të, i keni lënë te korporatat, t'i përfshijë korporata.

Arben Ahmetaj - Unë kam shumë respekt për pyetjet tuaja, sepse reflekton dituri dhe thellësi. Pse ma ngatërron tani korporatën me gjëra konkrete?! Kur të kaloni politikisht te qëndrimi, përmendini të gjitha që nga aeroporti, por tani dua të jemi konkretë.

Ky është procesi specifik i partneritetit publik- privat.

Artur Roshi – Procedurën e kuptuam. Unë jam i qartë, sidomos nga shpjegimi juaj.

Arben Ahmetaj- Ju falënderoj!

Artur Roshi- Pyetja për ministren është kjo: zonja Ministre, sa mendoni se do të rëndojnë në vite PPP-të ky borxhi i fshehtë apo qoftë edhe i drejtpërdrejtë, se pavarësisht që themi i fshehtë që nuk merret parasysh në borxhin e çdo viti? Sa vite do të rëndojë për të ardhmen e shqiptarëve? Bën vaki që rëndon edhe mbi fëmijët tanë, se nuk është problemi për ne. Për ne, për brezin tonë e ka marrë “ferra uratën”, por problemi është për fëmijët tanë. Fëmijët tanë, pa lindur do të kenë një borxh për të paguar. Çfarë kusuri kanë, për shembull fëmijët tanë? Siç e shikoj unë me 5% që keni vënë ju kufizimin, kjo zgjat 50 vjet. Shteti u ka detyrim këtyre PPP-istëve për të paguar. Buxheti i shtetit, me sa shikojmë, nuk është në gjendje për të përballuar investime kaq të mëdha. Këto investime kur nuk kanë efekt kthimi të menjëhershëm, nuk kanë sens pse të bëhen. Nuk e kuptoj pse i keni bërë. Çfarë efekti do të japë në ekonomi, për shembull Balldreni? Zero, sidomos në vitet e para. Do të jetë një kthim shumë i vonshëm luksi, në njëfarë mënyre për brezat që vijnë, por jo për ne. Ne nuk kemi ekonomi që të subvencionojmë luksin apo jo? Ne kemi ekonomi për të ruajtur ekzistencën, një herë të qytetarëve, por edhe të ekonomisë.

Arben Ahmetaj - Zoti Roshi, po mbani qëndrim?

Artur Roshi - Jo pyeta.

Arben Ahmetaj - Do t'ju lutesha të bëni pyetje, pastaj qëndrimin mbajeni politikisht siç e dini vetë më mirë ju sesa çdokush tjetër.

Po, zonja Ministre.

Anila Denaj - Në fakt, parashikimi shkon deri në vitin 2032, parashikimi në nivelin e Ministrisë së Financave sesi do të ndikojë. Unë, nëse keni pak durim, do t'ju them me përqindje çdo vit se sa do të rëndonte në kontekstin e përqindjes së tavanit. Në vitin 2020 3,3%, në vitin 2021 3,3%, në vitin 2022 3%, vijon nën ritmin e 3- 3,1% , fillon dhe ulet në vitin 2026 me 2,5% për të shkuar në 2% në vitin 2029 dhe 0,7% në vitin 2030.

Ky është parashikimi i 14 kontratave, të cilat kanë mbështetje buxhetore të ndara sipas dy zërave: investime, që janë në rrugë dhe shërbime që janë shpenzime korrente. Kthimin në ekonomi nuk e matim dot sot. Nuk e themi dot se është luks. Infrastruktura zhvillon ekonominë. Kjo nuk është element luksi. Është një kërkesë e të gjithë investitorëve për zhvillim, është e qytetarëve për të transferuar, është e një lëvizjeje të lirë të mallrave, të cilat shkojnë përtej Shqipërisë dhe në një rajon më të gjerë sesa Shqipëria. Po flasim për tregje rajonale dhe jo vetëm për treg lokal. Rritmi i përqindjes, siç e thashë pak më parë vjen dhe ulet ndaj tavanit të totalit. Në kontekstin e borxhit ne e trajtuam edhe para 2 ditëve. Unë trajtova në fillim të fjalës sime kontekstin e elementit “borxh” dy elemente shumë të rëndësishme. Ky është një deklaram, i cili nuk u mohohet qytetarëve. Pak javë më pas, në bashkëpunim me të gjithë punën e bërë dhe nga Banka Botërore në ndihmë të Ministrisë së Financave do të keni një informacion të detajuar të monitorimit të kontratave si pjesë e rolit të ri të kësaj ministrie, por informacioni vjen për çdo kontratë, në çdo informacion të tij dhe nuk është një informacion i cili, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në risqet fiskale që i përmendët pak më lart.

Më lejoni të them, zoti kryetar, që kontratat PPP, e kam thënë edhe më parë nuk janë kontrata, të cilat kanë filluar në këtë qeverisje. Do të bëj një parashtesë të numrave. Sot kemi 220 kontrata koncesionare. Kontratat koncesionare nuk janë asnjë risi për Shqipërinë, janë produkt i një zhvillimi ekonomik për shumë vende të Europës dhe të vendeve të zhvilluara. Nga këto kontrata në vitet 2004-2013 janë nënshkruar 176 të tilla nga 220. Kuptohet, këtu nuk janë të gjitha kontratat, të cilat kanë mbështetje buxhetore, sepse 14 prej tyre kanë. Vetëm 44 kontrata koncesionare janë nga viti 2013 – 2019.

Në raport edhe me kontekstin e propozimit të pakërkuar nga 176 kontrata të harkut kohor 2004- 2013, 171 janë të pakërkua për të njëjtin hark kohor. Konteksti i një kontrate të pakërkuar nuk është risi e kësaj qeverisjeje, por është një produkt, i cili ka ekzistuar edhe më parë dhe do të ekzistojë në limit të kufizimit ligjor që u caktua këtë vit, për ato projekte, të cilat kërkojnë një vëmendje më të shtuar ndaj kostos, siç janë: portet, aeroportet dhe projektet në energji. Për të gjitha të tjerat oferta e pakërkuar është limituar prej datës 1 tetor në të gjithë infrastrukturën rrugore, siç e përcakton ligji.

Arben Ahmetaj – Pra, çfarë ka risi në këtë qeverisje? Ka 3 risi në këtë qeverisje në krahasim me qeverisjet e mëparshme.

E para, është transparenca ndaj Kuvendit. Pse e them këtë? Edhe në vitin 2013, qeveria nuk ka pasur detyrim që të sjellë në Kuvend informacion të detajuar për çdo kontratë,

planet për të ardhmen në lidhje me kontrata të mundshme, tavanin e përqindjes së prodhimit të brendshëm bruto. Pra, nuk ka pasur. Me këtë qeveri ka.

Artur Roshi – Unë them sërish jo, por vazhdoni.

Arben Ahmetaj – Më falni! Ju mund...

Artur Roshi – Se vetë preventivat për shembull, që jepen për koncesionet e PPP-ve, nuk ishin të bëra nga qeveria...

Arben Ahmetaj – Zoti Roshi, do t’jua argumentoj edhe atë, vetëm në respekt të vëmendjes tuaj ndaj fjalëve të mia dhe të kolegëve. Duhet të më dëgjoni deri në fund, që pastaj të debatojmë me njëri-tjetrin edhe në favor të transparencës së çështjes.

Artur Roshi – Dakord!

Arben Ahmetaj – Po ju përmend skanimin. Skanimi s’u soll kurrë në Kuvend, por erdhi vetëm si ligj, për t’i vënë kapak. Doni Devollin apo Banjën? Për qytetarët, po e them...

Artur Roshi – Çfarë kishte Devolli, meqë e njoh mirë Devollin?

Arben Ahmetaj – Më falni! Patjetër, patjetër. Koncesionet e energjisë, që kanë ardhur, kanë ardhur që të gjitha me prim. Çfarë do të thotë kjo për qytetarët? Çmimi plus prim, që është garantimi i investimit. Një qytetar mund të thotë: Po mirë, kush e garanton këtë investim? Taksat e shqiptarëve...

Artur Roshi – Taksat e shqiptarëve.

Arben Ahmetaj – Ta mbaroj, një sekondë!

Artur Roshi – Kjo s’duhet të jetë.

Arben Ahmetaj – Po mirë, pra. Është bërë një hidrocentral, që dalim e mburremi majtas e djathtas?

Artur Roshi – Zero para buxheti i shtetit, zero para shqiptarët për Banjën e për Devollin.

Arben Ahmetaj – Jo, jo, një sekondë!

Artur Roshi – Për Devollin kam bërë oponencën, ndaj e di mirë.

Arben Ahmetaj – Ç’ke ti, do ta bësh dhe do të kthehesh mbrapsht te unë. Unë nuk po flas për hidrocentralet që nuk kanë marrë kontratë garantimi

të shitjes së prodhimit. Po flas për ato hidrocentrale-koncesione, që kanë marrë garanci dhe prim. Pra, çfarë është garancia dhe çfarë është primi? Sepse ju referuat...

Artur Roshi – Janë tuajat. Duhet të jenë tuajat, të qeverisë.

Arben Ahmetaj – Po prit pra, një sekondë!

Artur Roshi – Në rregull, s’besoj se të bezdis.

Arben Ahmetaj – Nuk më bezdis kurrë. Madje edhe kur pimë kafe, jo vetëm që nuk më bezdis, por edhe më iluminoj, por tani, së paku për qytetarët, dua të ma respektosh fjalën, me qëllim që ta dëgjojmë njëri-tjetrin: edhe ju të thoni tuajën, edhe ne të themi tonën. Ose unë të them tonën, në rastin konkret.

Janë kontrata koncesionare për hidrocentrale, të bëra para vitit 2013. Janë në funksion të rritjes së kapaciteteve energjetike, por, më duhet ta them, ka pjesë të rëndësishme të tyre, të cilat kanë çmim të negociuar përtej çmimit të tregut. Kjo do të thotë se atë prim e paguan qytetari nëpërmjet çmimit të energjisë elektrike, nëse doni direkt e indirekt, por po flasim direkt, te pagesa që i bën OSHEE-së. Pse? Se goditja i shkon OSHEE-së. Është njëllë sikur ky malli këtu të bëjë 10 lekë, po për shkak të një kontrate që kemi bërë për të garantuar shitjen e këtij malli, është bërë 12 lekë. Atë 2-lekëshin e paguan OSHEE-ja, e ha në kurriz buxheti i shtetit.

Tjetër, nëse doni mund të flasim sa i takon skanimin të doganës. Në mos gabohem, goditja në buxhetin e shtetit 1, 9 miliardë, plus minus, që do të thotë rreth 18 milionë dollarë në vit. E gjithë kjo histori, së cilës i referohemi duhet bërë transparente. Ajo së cilës iu referua ministrja ishte jo vetëm numri i kontratave, por në përqindjen e prodhimit të brendshëm bruto. Vërtetë që kontratat janë niveli 37, 7 %, në mos gabohem në 18 i ligjit të buxhetit të 2020-ës... 37, 7 janë? 37, 3. Nejse. Kjo është e para, transparenca.

E dyta, kjo qeveri vjen në Kuvend dhe i thotë: të lutem, Kuvend, më vendos...

Artur Roshi – Më mirato ato që unë bëj gabim.

Arben Ahmetaj – Jo, aty do të vish ti pastaj, kur të pozicionohesh me qëndrim politik, por ti je inxhinier dhe je i saktë teknikisht. Kësisoj, le të rrimë te teknikja. Pastaj, kur të flasësh, fol politikisht si të duash.

Pra, çfarë dua të them? Vjen qeveria dhe i thotë Kuvendit: dua të më vësh kufizim. Në ligjin organik të buxhetit, në 2016-ën, qeveria i ka ardhur këtij Kuvendi dhe i ka thënë: Kuvend, të lutem, më vërë kufizim për koncesionet. Dhe i ka vendosur 5-përqindëshin. Kjo është e dyta.

E treta, ka ardhur vetë qeveria dhe i ka thënë Kuvendit: Kuvend, duke të dëgjuar ty me vëmendje, kam arritur në konkluzionin se Kuvendi, por ndoshta edhe qytetarët, edhe institucionet ndërkombëtare, kanë një shqetësim në lidhje me ofertat e pakërkua. Kjo sepse në traditën e Europës, të Amerikës së Veriut apo të Amerikës Latine, kanë devijuar shumë koncesione, për shkak të atyre që quhen *contingent liabilities proper*, detyrimeve të fshehura që mund të kenë koncesionet. Një ditë të bukur, qeveria vjen e kërkon ndryshimin e ligjit, dhe heq ofertën e pakërkuar për transportin rrugor.

Artur Roshi – Po, mbasi ka mbaruar me të gjitha, mbasi ka gjithë Shqipërinë me koncesion.

Arben Ahmetaj – Jo, jo, nuk ka mbaruar Shqipëria...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, nevojat për infrastrukturë janë shumë të mëdha. A doni edhe një ushtrim tjetër? Çdo qeveri do të thoshte se ka edhe 2 % të prodhimit të brendshëm bruto për të kapur 5-përqindëshin. Po pse nuk tregohet qeveria e papërgjegjshme? Të vijë e të thotë: ja ku është, ja ku është! Qeveria e solli vetë këtë.

Artur Roshi – Sepse është në gropë e gjithë ekonomia, s'ka ku shkon. Në gropë potenciale.

Arben Ahmetaj – Në qartësinë e saj ka ardhur dhe i ika vënë kushte vetes. Pra, janë tre elementë shumë të rëndësishëm. Po mirë, tregojini popullit të Dibrës për Rugën e Arbrit, se ç'vlerë ka ajo rrugë për ta.

Artur Roshi – Do të paguajnë për pesëdhjetë vjet rresht taksa të gjithë shqiptarët, jo vetëm dibranët.

Arben Ahmetaj – Ka vlerën e jetës. Shkoni nesër dhe thojni se Rruga e Arbrit është e gabuar. Kryeministri Rama dhe të gjithë ne, kemi thënë: Rruga e Arbrit është e domosdoshme, dhe për herë të parë në historinë e Dibrës, do të lidhet me tregun, do të lidhet me portin, do të lidhet me kryeqytetin. Shkoni nesër e thojni...

Artur Roshi – Po ta dinë dibranët se do të paguajnë të gjithë shqiptarët për shkak të tyre, për tridhjetë a dyzet vjet me radhë...

Arben Ahmetaj – Për çdo rrugë paguajnë.

Artur Roshi – Nuk do të duan, ose...

Arben Ahmetaj – Zoti Roshi, po më ndërhyre, nuk do të lejoj të flasësh. Epo, do të kemi një rregull tani.

Për çdo rrugë. Doni t'ju sjell një shembull, sepse e diskutova edhe në komision me ministren? A e dini se kur ka ardhur projekti i Rugës së Elbasanit, e mbaj mend si tani sepse kam qenë deputet në opozitë. Erdhi Sherefedin Shehu, respekt dhe ndjesë që po ia përmend emrin këtu, dhe tha se është rruga më e lirë. Morëm syzet, se mezi shihnim që atëherë, e pamë. E mbaj mend çfarë kam thënë, kam qenë aty. Kam thënë: po, ta mbështesim Rugën e Elbasanit. Po çfarë na ndodhi me Rugën e Elbasanit? Nga 150 milionë shkoi 246 milionë.

Artur Roshi – Po ju e çuat.

Arben Ahmetaj – Të lutem tani, zoti Roshi, se po bëhemi të dy...

Artur Roshi – S'e latë firmën "Aktori", që ta mbaronte.

Arben Ahmetaj – Një sekondë!

Artur Roshi – E ndërpretë për arsye abuzive.

Arben Ahmetaj – Zoti Roshi, s'ka vlerë kjo që po bëjmë ne.

Artur Roshi – Dakord, dakord!

Arben Ahmetaj – S'ka vlerë, ne po flasim për qytetarët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Po do të mbash qëndrim tani.

Artur Roshi – Thua: jo procedura, jo andej-këndeje. Mediet kanë ikur, i keni tuajat. Vetëm me muret të mbaj qëndrim?

Arben Ahmetaj – Të lutem!

Artur Roshi – Po mirë, pas jush, të mbaj qëndrim?

Arben Ahmetaj – Patjetër.

Artur Roshi – Dakord!

Arben Ahmetaj – Të bëj thirrje miqësore. Çdo njeri, mjaft që të mos ia ndërpresim fjalën njëri-tjetrit.

Artur Roshi – Dakord!

Arben Ahmetaj – Rruga e Elbasanit. Nuk po i hyj duke thënë: jo u hap, jo s'u hap, ra tuneli, s'ra tuneli, se ato janë politike. Unë po marr shifrën. Shifra kërceu nga 150 milionë në 246 milionë. Tani, a mund të më thoni: ky pothuaj 100 milionëshi, 96-milionëshi ishte *contingent liability*, ishte detyrim i fshehur? Çfarë ndodhi? Ndodhi që projekti nuk ishte i saktë, ndaj u rrëzua gjithë pjesa e kodrës. Pastaj filluan historitë dhe shifra shkoi në 100 milionë plus.

Doni rastin e Qukës-Qafë Plloçë, në lidhje me të cilën e pyeta ministren, jo pa qëllim? E dini çfarë ka ndodhur? Erdhi sërisht Sherefedin Shehu, gjithnjë në respekt të tij, në këndvështrimin tim burrë i zoti në punën që ka bërë, dhe na argumentoi paketën financiare. E lirë ishte. U gëzuam shumë. Votoi edhe opozita e atëhershme. Isha deputet opozite. Madje diskutuam edhe me zonjën Kodheli, që ishte nënkryetare: po, është një projekt me kosto të lirë.

Çfarë po na ndodh sot? E dini çfarë po na ndodh sot? E dinë qytetarët, që i bien akoma nga Pogradeci, ca për qejf të tyre, ca jo për qejf të tyre? Projekti nuk përputhej. Nuk përputhej ana e majtë e rrugës me anën e djathtë. 17 metra diferencë. Kosto, kosto, kosto. Nuk e dimë sa do të shkojë kostoja.

Pse i them këto? Këto i them sepse, po të jetë puna për të keqinformuar publikun shqiptar, është në të drejtën tuaj të mbani qëndrime politike sa të doni, ama kur vijmë në këtë

komision, i cili është komisioni numër 1 i Kuvendit, në këndvështrimin tim, baras me atë të ligjeve, ata për çështjet e veta, ne për çështjet ekonomike. Qëndrimet janë politike, si të doni, ama kur flasim teknikisht,...

Artur Roshi – Kryetar, qëndrimi im është teknik, s'ka lidhje me politikën.

Arben Ahmetaj – Dakord, dakord, kur flasim për pozicionime teknike shifrash, statistikash e procedurash, duhet të jemi shumë transparentë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka kërkuar zoti Roshi, për qëndrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ia jep kryetarit të grupit të...

Artur Roshi – Ia jap, por puna është se duhet ta marrë për të shpjeguar këto koncesionet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Zoti Roshi atëherë. Vazhdo, zoti Roshi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, e drejtoj unë. Zoti Roshi, vazhdo. Të premtoj se nuk do të të ndërhyj.

Artur Roshi – Dakord!

Arben Ahmetaj – Ndryshe nga ti.

Artur Roshi – Meqë thatë, publiku ka interes për të sqaruar koncesionet e para vitit 2013, apo të qeverisë Berisha, dhe koncesionet e qeverisë suaj. Sipas meje, teknikisht, besoj se e drejta shkon te kjo që po them. Marrim Rrugën e Elbasanit. Rruga e Elbasanit ka pasur një kontratë me kompaninë greke “Aktor”, e cila do ta përfundonte, do të shponte tunelin e do të bënte edhe segmentet jashtë tij. Kur erdhi qeveria juaj, e shtoi me gati 100 milionë lekë të tjera, apo nëntëdhjetë e ca milionë. Pse e shtoi? E shtoi me pretekstin se projekti nuk ishte korrekt, me pretekstin se nuk ishin bërë shpime gjeologjike të rregullta, se s'ishte bërë studimi gjeologjik. Unë them se të gjitha këto janë një farsë, ose nuk përbëjnë argument bindës për publikun apo për ata që janë inxhinierë. Lind pyetja: përse nuk e latë kompaninë ta përfundonte kontratën?

E dyta, të gjithë kemi kaluar aty, dhe ju keni bërë një tunel panoramik. Rrëshqiti një sasi e vogël dheu, që me një ekskavator mund të hapej. Nuk ishte nevoja për atë tunel panoramik, i cili më duket se mori 10 a 15 milionë euro, nuk më kujtohet mirë.

Tani, cili është thelbi te koncesionet? Te koncesionet tuaja, që nga sot dhe për tridhjetë a dyzet vjet të tjera, shqiptarët do të paguajnë nga buxheti i tyre familjar, ndërsa për koncesionet e qeverisë Berisha nuk paguajnë asnjë lek as buxheti i shtetit e as shqiptarët. Pse?

Sepse në njëfarë mënyre, ata marrin vetëm të drejtën koncesionare. Si të thuash, është një patentim apo një dhënie licence për një gjë të caktuar, pra për të shfrytëzuar një aset publik. këtë Ka bërë. Pra, për të shfrytëzuar lumenjtë, kompanitë kanë lidhur kontratë me qeverinë Berisha, për t'i zhvilluar, po asnjëherë nuk kanë marrë gjë nga buxheti i shtetit. Pra, të gjitha janë financime private.

Tashti, vijmë te qeverisja juaj. Ju jo vetëm që vazhdoni t'i mbështesni me taksat e shqiptarëve, por thoni se koncesionet tona janë më të mira se koncesionet tuaja. Te ju nuk ka sens fjala koncesion, nuk qëndron fjala koncesion. Nuk ka elemente të saj, është vetëm fjala, por nuk ka strukturën se si jepet një koncesion.

Vijmë te koncesionet e energjisë. Koncesionet e qeverisë "Berisha" u realizuan dhe kanë filluar të bëhen aktive në tregun energjetik, pra të shesin energji dhe të integrohen në rrjet. Pse nuk ka rënë çmimi? Ju morët përsipër uljen e çmimit dhe bëtë të kundërtën, rritët çmimin e energjisë. Në 6 vjetët e qeverisjes suaj kanë vazhduar të futen koncesionet në rrjet. Po çmimi përse nuk ulet? Investimet bëhen për dy arsye: e para, ose të ulin çmimin, ky është qëllimi, dhe e dyta, të merret shërbimi ose produkti më i mirë. Këto të dyja janë elementet thelbësore të bërjes së një investimi. Në qoftë se ju bëni investime abstrakte në tym, kjo është tjetër gjë, dhe i shisni ato në emër të investimit, a duhet të pranojmë që "investimi" është një fjalë që duhet t'i bindemi të gjithë? Jo, kur atë e bën kot, nuk vlen!

Arben Ahmetaj – Ju thatë pse nuk bie çmimi i energjisë, zonja Ministre, keni ndonjë qëndrim?

Belinda Ikonimi - Ju e përmendet pak më parë në qëndrimin tuaj, në raport me çmimin, kontratat vërtet nuk mund të marrin para nga buxheti i shtetit, por kontratat që lidhen qoftë edhe ato koncesionare në kosto të drejtpërdrejta dhe të biznesit apo kontrata me çmime të paracaktuara për shumë vite janë kosto, edhe pse jo të drejtpërdrejta. Këto janë kontrata, të cilat nuk do ta ulin çmimin për sa kohë kanë këtë element që u përmend pak më parë.

Shumë e rëndësishme është edhe cilësia e shërbimit, flasim përtej kontekstit energjetik apo të rrugëve. Kemi kontrata, të cilat në kontekstin e shërbimit kanë përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shërbimit në shëndetësi. Kundrejt çdo elementi të komentuar për vlerën e tyre, janë kontrata, të cilat qoftë në parandalim të sëmundshmërisë, ashtu edhe në rritjen e shërbimit të sterilizimit të mjeteve apo ajo e laboratorëve që do të fillojë që prej vitit që vjen, janë kontrata shërbimi, të cilat në një shëndetësi janë falas, merren falas nga qytetarët, pavarësisht se paguan buxheti i shtetit...

Arben Ahmetaj – Do t'u lutesha gjithë anëtarëve të komisionit, nuk dua t'i ndërhyjnë ministres dhe kjo është procedurë e shkruar.

Së dyti, në qoftë se duam të jemi seriozë edhe në sytë e shqiptarëve, nuk dua t'i ndërhyjmë njëri-tjetrit, në respekt të asaj që thotë njëri apo tjetri. Do të jenë qytetarët ata që do të na gjykojnë. E kam kërkesë edhe miqësore, por edhe procedurale.

Ministrja është përfaqësuese e qeverisë dhe në respekt si të sajën personal, si të qeverisë, duhet ta dëgjojmë dhe më pas bëni pyetje pa fund. Për këtë paguhemi, të monitorojmë qeverinë, të bëjmë pyetje dhe të mbajmë qëndrime.

Do të fillojmë nga pozita: ju thatë “Koncesionet tona, koncesionet tuaja”, unë nuk do të flisja kështu, por do të flisja ndryshe. Do ta merrja Republikën e Shqipërisë si një të vetme, qeverinë si një, dhe pastaj qeveritë se cila ka punuar më mirë apo më keq, shqiptarët shkojnë në votime dhe reflektojnë për atë që duan.

Ju pyetët nëse ka pasur kosto buxhetore ndonjë koncesion apo PPP i bërë para vitit 2013. Në qasjen time publike, por jo vetëm, unë nuk e ndaj, as nuk shaj Saliun, Luli apo iks ipsilon, këtë nuk e bëj kurrë edhe përtej mureve. Unë dua që të nxjerrim statistikisht të vërtetën dhe politikisht të mbajmë qëndrime të bazuara në statistika korrekte, pastaj do të jenë qytetarët që do të na gjykojnë.

Buxheti i shtetit po paguan për skanimin. Çdo vit, në mos gaboj, e ka filluar në vitin 2015 me 12 milionë dollarë dhe sot ka shkuar te 18 milionë dollarë.

E dyta, rruga e “Banjës” është 50 milionë euro. Brenda kontratës së koncesionit të energjisë, qeverisë i ishte lënë detyrim të ndërtonte rrugën me 52, 53 milionë, e cila u pagua nga buxheti i shtetit. Qytetarët duhet ta dinë këtë.

E treta, iu referuat koncesioneve të energjisë. Ato kanë kosto në buxhet indirekt, sepse OSHEE-ja paguan mbi çmimin e tregut për koncesionet për ato që quhen PPP, hidrocentralet private dhe do të paguajë të paktën për 10 deri në 12 vjet. Vetëm këtë vit kostoja ka qenë gati 40 milionë euro plus dhe këtë, të dashur qytetarë, e paguan kompania publike direkt, në finale paguhet nga buxheti i shtetit me mbështetje buxhetore, me faljen e ripagesave që nuk ka bërë as OSHEE-ja dhe as KESH-i në buxhetin e shtetit dhe, kur të shkojnë në buxhetin e shtetit, i bie që kanë paguar qytetarët në mënyrë direkte dhe indirekte. Pra, të jemi të qartë me njëri-tjetrin. Pastaj, nëse janë të mira ato apo të këqija, ky është një diskutim që ejani ta bëjmë emocionalisht.

Unë mendoj se rritja e kapaciteteve energjetike ka qenë, është dhe duhet të vazhdojë të jetë. Do mbështetje buxhetore, këtu ndahen. Unë mendoj se direkt apo indirekt, shteti nuk duhet të japë marrëveshje të garantuar të blerjes së prodhimit. Por ky është një diskutim që nuk duhet bërë sot këtu.

Po, zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Është e vërtetë që kontratat koncesionare dhe ato të partneritetit publik privat kanë qenë ndër çështjet më të debatuar vitet e fundit midis maxhorancës dhe opozitës. Mendoj se gjatë këtyre viteve kemi fituar një përvojë që tashmë duhet të na vlejë për suksesin e kontratave gjatë viteve në vazhdim.

Bazuar pikërisht në problematikat që janë shfaqur gjatë viteve, gjithashtu bazuar edhe në rekomandimet e FMN-së apo Bankës Botërore, ne e përmirësuar ligjin me disa ndryshime. Dy ishin kryesoret, heqja e bonusit për propozimet e pakërkua dhe rritja e rolit monitorues, kontrollues, mbikëqyrës të Ministrisë së Financave për këto kontrata. Madje ky rol, vlerësimi i tyre, fillon që nga hartimi i kontratave e deri në zbatimin e të gjitha etapave.

Pyetja ime konsiston pikërisht te kjo e dyta, forcimi i rolit të Ministrisë së Financave për këto kontrata. Do të doja të dija: si po e ushtron kjo ministri këtë rol të shtuar?

Çfarë problematikash ka konstatuar gjatë këtyre muajve që ka hyrë në fuqi ligji i ri?

Ju thatë pak më parë se po përgatisni një raport me të gjitha monitorimet që keni bërë dhe së shpejti do të jetë në dispozicionin tonë. Deri sa të jetë gati ky raport, a mund të kemi një informacion paraprak për problematikat që ju konstatojnë në kontratat koncesionare apo të partneritetit publik privat? Ndoshta mund të ndaleni edhe në kontrata specifike. Ne do t'i kemi ministrinë e linjës, qoftë ministren e Energjisë dhe Infrastrukturës apo të Shëndetësisë, ku janë edhe pjesa më e madhe e këtyre kontratave, por megjithatë, desha të di nga ju nëse keni konstatuar problematika, cilat janë kontratat që po ecin më mirë dhe çfarë masash po merren, sepse, në fund të fundit, ky rol kontrollues e mbikëqyrës shërben pikërisht që të merren masa për zgjidhjen e këtyre problematikave.

Faleminderit!

Belinda Ikonomi – Në fakt, janë 3 elemente shtesë në ligj, unë i thashë pak më parë në fjalën time dhe ne jemi duke përgatitur të gjithë pjesën e akteve nënligjore për ta bërë ligjin totalisht të aplikueshëm.

Është shumë e rëndësishme të përmendim edhe elementin e tretë shumë të rëndësishëm, krijimin e Komitetit Përzgjedhës të Projekteve PPP, sepse edhe ky është një element që do të zgjidhte jo pak ngërçe edhe në aspekt të nevojës së analizave të fizibilitetit dhe të të gjithë kostopërfitueshmërisë, e cila është diskutuar këtu gjatë ditës së sotme. Megjithatë, raportin paraprak të përmbledhur për vitin 2019, e kemi punuar këta dy muaj së bashku me Bankën Botërore. Vërtet ligji e filloi efektivitetin e tij në 1 tetor, por, për sa kohë që ky ka qenë një diskutim prej disa muajsh, ne e filluam punën për të mbledhur të gjithë informacionin nga të gjitha institucionet, autoritetet kontraktore, pasi, sikurse e dini, Ministria

e Financave ka një zë në çdo proces, por nuk kishte zërin final dhe ndryshimi ligjor që iu bë është se, pavarësisht ndryshimeve që mund të ndodhin gjatë rrugës, të kthehet përsëri për një gjykim final, qoftë në aspektet financiare dhe juridike para se të vijojë më tej.

Banka Botërore ka asistuar në përgatitjen e raportit dhe po na ndihmon njëkohësisht në ngritjen e kapaciteteve të brendshme, megjithatë koha është e limituar, sepse janë gati 2 muaj, raporti është gati. Unë mendoj që raporti nuk ka version të shkurtër, por është i detajuar dhe besoj që brenda 3 javëve në vijim, sa të kalojë të gjithë filtrat e kontrollit, do të jetë për dijeninë e të gjitha palëve. Kështu që një raport i shkurtër paraprak do të ishte i panevojshëm.

Megjithatë, më lejoni të theksoj se në kuadër të transparencës, çdo kontratë koncesionare gjendet sot në faqen e ATRAKO-s, që është agjencia që menaxhon kontratat koncesionare, e cila ka informacion të detajuar për të gjitha kontratat koncesionare dhe sigurisht që pjesë e këtij raporti janë edhe këto informacione dhe më tej.

Në aspektin e kapaciteteve të brendshme të Ministrisë së Financave, në diskutimin e djeshëm për menaxhimin e borxhit ne kemi thënë se asnjëherë strukturat nuk janë të mjaftueshme, megjithatë besojmë se kemi eksperiencë të ngritur dhe asistencën që më vonë do të jetë e vyer.

Raporti brenda 3-4 javëve do të bëhet publik.

Për informacion më të përgjithshëm, ATRAKO është aktualisht...

Arben Ahmetaj – Jo, nuk do t'i referohemi ATRAKO-s, por juve, zonja Ministre. Ne nuk kemi punë me ATRAKO-n për informacionin, kurdo që ta keni gati do të na e sillni ju.

Faleminderit për shpjegimin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është *online*, kështu që ka edhe një sistem të ndërtuar që mund t'i referohet kushdo qoftë, por besoj që raporti do të na vijë nga ju.

Zoti Roshi, fjala për ju.

Artur Roshi – Faleminderit, kryetar, që më dhatë të drejtën të bëj edhe pyetjen e fundit!

Zonja Ministre, a ju bie në sy juve që qytetarët paguajnë dy herë për PPP-të, një herë paguajnë borxhin që i merr shteti privatit, dhe herën tjetër paguajnë kredinë që privati merr në bankë? Pra, kemi një mbivendosje pagesash.

Pyetja është shumë e thjeshtë: pse nuk keni zgjedhur kompani të huaja që kanë kapitale, të cilat nuk kanë nevojë të marrin borxh te bankat, sepse kompanitë shqiptare, mesa kemi parë, nuk kanë kapitale dhe gjendjen e tyre financiare nuk e kanë të deklaruar nëpër bilance në mënyrën reale? Çfarë bëjnë ato, në momentin që firmosin kontratën PPP-në ato iu

drejtohen bankave. Do të thotë se nuk i kanë paratë e tyre dhe qytetarët një herë paguajnë interesin bankar për llogari të privatit, kompanisë shqiptare që është e pamundur të investojë, dhe një herë tjetër paguajnë paratë që i marrin borxh privatit për llogari të shtetit. Pra, shqiptarëve u ecën e gjithë jeta duke paguar. A ju ka rënë në sy kjo gjë?

Belinda Ikonomi – Zoti Roshi, është shumë e rëndësishme të moskeqinformojmë publikun, në radhë të parë.

Nuk mendoj se sot jemi në pozitat për të bërë teorinë se si procedura e përzgjedhjes në kontekstin financiar çon në fitues të atij që do të punojë mbi një kontratë koncesionare.

Është e sigurt se terminologjia për të vendosur fituesin përcaktohet në terma përfitueshmërie tregu dhe jo duke i shtuar kësaj edhe normën e financimit. Është një analizë financiare që e bën banka, jo shteti. Në të gjithë rolin që ka autoriteti kontraktor për të përzgjedhur fituesin ka tregues, të cilët kanë të bëjnë me përfitueshmërinë, janë tregues tregu dhe nuk janë të lidhur me burimet financiare që merr kompania. Nëse kompania ka marzhe më të ulta, sepse ka kosto financiare për të paguar kredinë, kjo është pjesë e tyre. Ne flasim për përfitueshmërinë e një projekti brenda treguesve, të cilët janë mbështetur në tregues tregu dhe jo tregues financiarë të kompanisë.

Blerina Gjylameti – Faleminderit!

Mendova të respektoja opozitën për t'i dhënë më shumë të drejtën e fjalës.

Pyetja ime ka të bëjë me një seancë dëgjimore që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës ka pasur dje për buxhetin e kësaj ministrie në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese. Nga ajo që dëgjova për pjesën e vazhdimin të mëtejshëm të financimit të disa prej kontratave më të rëndësishme të infrastrukturës dhe mungesës së fondeve për të vazhduar me to, një prej tyre ishte rruga Milot-Balldren dhe disa rrugë të tjera. Unë do të doja të dija si vazhdon pjesa e financimit për këto kontrata, sa e mundur është në buxhetin e shtetit të vitit 2020. Të gjithë ato angazhime që kemi ndërmarrë, pra angazhime ligjore të kontratave koncesionare, që kanë kaluar në parlament janë një sërë prej tyre. Si qëndrojnë me pjesën e buxhetit? Sa mund të vazhdojmë t'i financojmë ato? Gjithashtu, dua të di nëse kemi kontrata të tjera, të cilat janë ndërmarrë gjatë vitit të kaluar mundësinë në buxhet për të filluar punë në vitin 2020. Nuk desha të përmend emra konkretë, por edhe mund t'ju them.

Arben Ahmetaj- Më falni, zonja Gjylameti, ju iu referuat ministres së Infrastrukturës për projekte të ndryshme?

Blerina Gjylameti- Po. Pjesa e parë e pyetjes kishte të bënte me dëgjuesin nga Komisioni i Veprimtarive Prodhuese.

Arben Ahmetaj- Më falni, nuk e ka ndjekur dje mbledhjen e komisionit. Çfarë tha ministrja?

Blerina Gjylameti – Titulli ishte nëse nuk do të quhej buxheti i infrastrukturës për shkak të disa kontratave që nuk mund të financohen. Tani pyetja që unë kam është: si qëndron fakti i fondeve që do të akordohen nga buxheti i shtetit për këto kontrata? Pyetja e dytë kishte të bënte me ato angazhime që ne kemi marrë nga kontratat koncesionare të mëparshme si është pjesa e buxhetit të shtetit, si mund të financohen ose jo dhe a do të fillojnë në vitin 2020?

Anila Denaj – Të gjitha detyrimet kontraktuale janë të përfshira dhe këtë e kam thënë edhe në prezantimin e parë dhe vijoj ta them, sepse ky është një detyrim ligjor, përfshirë këtu edhe kontratën e re që fillon në vitin 2020, në raport me shërbimet laboratorike spitalore, të cilat sigurisht kanë një risi në shërbim të qytetarëve sikurse edhe një kosto në buxhet të shtetit. Të gjitha këto të përfshira janë 3,3 % në raport me tavanin e të ardhurave.

Megjithatë diskutimi në raport me shumën për të përfunduar investimet, të cilat qoftë edhe në projektbuxhetin afatmesëm të parashikuar një vit më parë mund të limitojnë vitin 2020, janë diskutime që ndodhin në mes ministrive kur ka shkurtime buxhetesh. Unë e thashë edhe kur folëm në raport me të ardhurat e pritshme të vitit 2019 se ne kemi ngrirë projekte edhe këtë vit në mënyrë që të mos rrezikojmë asnjë parametër fiskal dhe kryesisht këto janë investime në infrastrukturë, të cilat në momentin më të parë që ne shikojmë realizimin e të ardhurave brenda pritshmërive të kuadrit fiskal mund të shkrihen, në të kundërt nuk do të vijnë dhe do të shtyhen për një vit më pas. E njëjta do të shkojë edhe në raport me vitin tjetër. Në raport me PBA-në e parashikuar një vit më parë ne e kemi thënë edhe me parë që ka një ulje për investimet kapitale, të cilat sigurisht ndikojnë edhe në infrastrukturë dhe në kontekstin e shtyrjes me një vit të disa projekteve.

Blerina Gjylameti - Meqenëse jemi në Komisionin e Ekonomisë, në lidhje edhe me zonën ku unë jam deputete, dua të shtroj një çështje që lidhet me një nga kontratat koncesionare për rrugën Milot- Balldren dhe rrugën e Ndroqit që lidhet me Durrësin. Parimisht është diskutuar që do të ishte përfshirë në kontratën koncesionare të Milot-Balldrenit dhe do të ishte një nga investimet kryesore për të nxitur turizmin në atë zonë dhe ekonominë vendase dhe si një pikë shfryrëse që lidh me Durrësin. Do të doja të dija për këtë kontratë si parashikohet fondi i buxhetit të shtetit dhe a është te kjo pjesa që ka ngrirë dhe do të rishikohet për vitin tjetër pasi të shikojmë realizimin e të ardhurave apo është përfshirë konkretisht?

Anila Denaj – Më lejoni të them se sa është parashikuar kjo kontratë në totalin prej 14,6 miliardë lekësh, që zë në vitin 2020, 14 kontratat koncesionare, pra në vitin 2020 100 milionë, në vitin 2021 10 milionë dhe vijon 312 milionë në vitin 2022 për të vazhduar më tej me rritjen e shumës.

Arben Ahmetaj- Në 3 vjetët e parë është 300 milionë?

Anila Denaj- Në tre vitet e para është 500 milionë.

Arben Ahmetaj - Po nëse Milot-Balldreni bën në atë kusht që ka në kontratë 25%-shin, çfarë ndodh?

Anila Denaj – Sigurisht, do të rishikohet PBA.

Arben Ahmetaj – Pra, nëse PBA-ja është në rënie dhe Balldreni futet brenda me pagesë të plotë, i bie që të supresohen investimet e tjera.

Anila Denaj- Po. Ky investim në kontekstin më të mirë të mundshëm do të jetë në gjykimin e Ministrisë së Infrastrukturës për të vendosur.

Arben Ahmetaj - Jemi duke folur për një angazhim kontraktual, që do të thotë se rruga Milot-Balldreni ecën me 25% në një virtualitet. Pra, Dibra nuk është qytet virtual dhe kur bëhen rrugët kapin një zonë specifike të caktuar me qytetarë që kanë nevojë si ata të Vlorës, Shkodrës që të kenë koniktitivitet. Po flasim për rrugën konkrete për pyetjen që bëri zonja Gjylameti. Nëse për tre vjetët që vijnë në PBA, është 500 milionë lekë, nëse kompania bën 25% të punimeve dhe ju do ta rikoni PBA-në dhe PBA-ja vjen duke i ulur në përqindje të prodhimit të brendshëm bruto investimet publike, dhe, nëse Ministria e Financave dhe Infrastrukturës do të detyrohet që të paguajë kompaninë mbi bazë të detyrimeve kontraktuale, a do të ulen investimet e tjera publike?

Anila Denaj – Detyrimet kontraktuale prevalojnë, por ministria do të shikojë projektet në avancimet që kanë punuar projektet e tjera dhe do të riallokojë nëse do të shikojë të nevojshme fonde nga projektet më pak produktive në projektet më shumë produktive. Kjo është një formulë, e cila flet me një tavan të ardhurash, nëse të ardhurat shtohen në raport edhe me parashikimin e vitit tjetër, sigurisht kjo do të çojë drejt një akti normativ të ri. Në fund do të kthehemi për të parë se cilat projekte nuk kanë avancuar dhe mund të riallokojmë fonde.

Arben Ahmetaj – Në referencë të fjalës suaj, detyrimet kontraktuale do të prevalojnë thatë ju. Kam një pyetje që dua të m'i përgjigjeni me shkrim: Në detyrimet kontraktuale që ju keni sa i përket kontratave, në rastin jo vetëm të Ministrisë së Infrastrukturës, por po pyesim për Ministrinë e Infrastrukturës në vazhdim të pyetjes që bëri zonja Gjylameti, a ka kontrata të cilat kanë detyrim ligjor kuantativ të caktuar që nuk

financohen megjithëse është detyrim ligjor? Këtë përgjigje nuk e dua tani, e duam me shkrim qoftë për ato që financohen nga llogaria kapitale, qoftë ata që financohen nga 602-shi, pra nga shpenzimet korente operative?

Anila Denaj – Po, do ta japim me shkrim përgjigjen për të gjitha.

Arben Ahmetaj –Pra, një sqarim që ta kuptojmë logjikën edhe për ta lidhur me PBA-në ndër vite.

Blerina Gjylameti – Vetëm për ta saktësuar, zonja Ministre, në mos qofsha e gabuar, totali i detyrimeve që lindin nga kontratat koncesionare është në 3,3% të të ardhurave, pra ne jemi poshtë tavanit të vendosur 5. Kjo vlen për t'u theksuar dhe besoj se duhet theksuar për sa kohë kemi marrë detyrime angazhime dhe po i respektojmë ato. Kjo ishte për publikun.

Faleminderit.

Arben Ahmetaj– Zoti Korab.

Korab Lita – Faleminderit!

Kam një replikë me ju, zoti kryetar, mbase duhet ta kisha thënë menjëherë pasi folët ju, por, meqë nuk ma dhatë fjalën, po e them tani.

Më ngacmuat pak në lidhje me prononcimin tuaj që për përshëndetjen për mbarimin e Rugës së Arbrit. Duke qenë se jam me origjinë andej dhe kam shijuar njërin nga dy arteriet kryesore të Rugës së Kombit dhe pres të shijoj edhe pjesën tjetër, dy janë arteriet kryesore që janë filluar në periudhën e demokracisë në veri, Rruga e Kombit dhe Rruga e Arbrit. Të dyja të filluara nga qeveria e Partisë Demokratike, njëra u mbarua, por tjetra “u la rrugëve”, siç i pëlqen Kryeministrit ta thotë.

Opinionimi ose mënyra e bërjes politike midis nesh dhe jush ndryshon. Unë jam i sigurt që të gjithë ne deputetët e opozitës do ta përshëndesim fuqishëm nëse do të mbarohet ajo rrugë, ashtu siç kemi një realitet tjetër që të gjithë qytetarët janë dëshmitarë për atë që keni bërë ju kundër ndërtimit të Rugës së Kombit, megjithatë ajo rrugë u ndërtua dhe të vetmen punë që bëtë ju i vendosët taksën.

Sa i përket Rugës së Arbrit, e kam dëgjuar unë disa herë që kur ka shkuar Kryeministri në Dibër u ka thënë dibranëve e gëzofshi rrugën, ndërkohë që ajo nuk është kurrkund akoma. Ajo rrugë duhet të përfundojë, pastaj do ta përshëndesim të gjithë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Specialistë janë vetë ata e dinë, e çojnë aty ku duan. Unë theksova vetëm pjesën politike.

Arben Ahmetaj– Nuk ishte replikë, ishte qëndrim, sepse replikë në komision nuk ka.

Unë nuk thashë mos bëni politikë, unë thashë bëni politikë, por kur flasim teknikisht, unë ju luta, pastaj zgjedhjen e keni ju, por kam një sugjerim: a e dini sa keq dukemi kur i ndërhyjmë njëri-tjetrit? Thonë qytetarët “Këta nuk janë seriozë”, prandaj ta marrim me nge!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk do të bëhet me taksë Rruga e Arbrit. Edhe Kryeministri, kur u ka thënë “ta gëzoni!” e ka mbajtur fjalën. Rruga e Arbrit ka filluar dhe ka avancuar jashtëzakonisht. Në fakt, të gjitha ato që kemi thënë po i bëjmë. Prandaj meqë bërë politikë, po bëj dhe unë politikë.

Të lutem, mos e ndiz atë, që të mos e mbyll komisionin! Unë nuk të ndërhyra. Të lutem, se kështu nuk jemi seriozë.

Rama, vetëm për premtimet që ka mbajtur, do të marrë mandat të tretë, ju garantoj për këtë, ju mund të filloni të flisni politikisht e të thoni ju pëlqen apo nuk ju pëlqen, por politika aty është. Në mandatin e tretë do të bëjmë edhe më shumë punë se kemi bërë deri tani. Po bëj politikë, se më takon.

Faleminderit!

Tani mund të më kthehesh sa të duash!

Korab Lita – Duhet ta mbaroni atë rrugë, ose gjithçka tjetër, që të thoni “e gëzofsh!”, se nuk mund të thuash “e gëzofsh!” për diçka që nuk e ke.

Arben Ahmetaj - Dakord, por kërkoni që Ministria e Financave ta financojë!

Korab Lita – Ku është rruga?

Arben Ahmetaj – Votoje atë buxhetin, sepse sivjet Ministria e Financave ka sjellë buxhetin për vitin 2020, ka sjellë edhe për Rrugën e Arbrit. Ti më the që je dibran, e qofsh me shëndet, se në respekt të plotë ndaj dibranëve unë kam një dynja me miq personal e familjar, edhe politikë, po deshe. Thuaji ministres faleminderit edhe Kryeministrit, i cili po e financon Rrugën e Arbrit me konsekuencë.

Korab Lita – Jo vetëm atë, por çdo punë të mirë që bën. Unë ta thashë, por nuk ishe i vëmendshëm, se ishe në telefon. Çdo punë e mirë që do të bëhet nga çdo qeveri, unë do ta përshëndes, por duhet të mbarohet më parë. Nuk është mbaruar, se unë vazhdoj akoma të shkoj në Dibër nga rruga e vjetër, e cila është gjithë gropa.

Arben Ahmetaj – Pse, brenda 6 muajve do të mbarojë?

Korab Lita – Ka 30 vjet. Mbaroje, pastaj thuaj “e gëzofsh!”

Arben Ahmetaj - Faleminderit, i dashur!

Zonjë, ju lutem!

Edlira Hyseni – Përshëndetje!

Unë po flas më shumë teknikisht se politikisht.

Në fillim do të thosha që unë do ta pres raportin sepse në një relacion kaq të gjatë për buxhetin, për koncesionet është vetëm një pasqyrë në *word*, se në *excel* na mungon, dhe nuk kemi pasur mundësi t'i shihnim më në detaje shifrat. Domethënë, shpjegimi për këtë listë koncesionesh mungon në këtë relacion. Në zërat e tjerë kemi më shumë informacione, por ju thatë që do ta sillni kështu që jemi në pritje. Ajo që mund të themi, meqenëse çështja e koncesioneve dhe e PPP-ve është e zhurmshme e dyshuar apo e debatuar, është se me sy të parë shihet që është respektuar limiti 37,7, ose rreth 40% e PBB-së, ose janë 5,5 miliardë euro detyrime. Në 5,5 miliardë euro, 3,3 janë vetëm HEC-e.

Arben Ahmetaj – Kërkoj ndjesë, por nuk janë detyrime, por vlerat e kontratave.

Edlira Hyseni – Po, vlerat e kontratave. Më falni!

Arben Ahmetaj – Duke t'u referuar ty që je shumë korrekte në shifra, të gjithë qytetarët që të kanë ndjekur dhe më kanë dërguar SMS thonë që, nëse ti thua detyrime 5,5 miliardë, ata llahtarisen.

Edlira Hyseni – Ndjesë!

Vlera totale e kontratave koncesion+PPP është 5,5 miliardë euro, nga të cilat 3,3 miliardë euro janë vlerat e kontratave vetëm për HEC-e. Unë nuk e dija që ishin kaq shumë, nuk e di dhe numrin, se këtu nuk thuhet se sa janë HEC-et në total private të ndërtuara, besoj në këta 30 vjet, por a ka prej tyre që nuk janë funksionale, pra që janë kontrata të parealizuar, të dështuara, të ngecura, apo të pezulluara? Në këtë listë të gjatë HEC-esh a ka ndonjë informacion më të saktë lidhur me afatet e tyre të kontratave, të vlerave? Cilat janë të suksesshme dhe operative dhe cilat kanë ngecur, ose nuk janë realizuar dot? A ka projekte të reja, sepse, me sa shoh, nuk kemi lënë lum apo përrua? A do të respektohen burimet natyrore të vendit tonë, zonat e mbrojtura etj, pra të gjitha ato preokupime që qytetarët shqiptarë kanë lidhur me ndërtimet pa kriter, ose dhënien pa kujdesin e duhur të lejes për ndërtimin e hidrocentraleve? A keni projekte të reja për vitin 2020 dhe a do t'i jepet prioritet detyrimit që kemi për të mbrojtur burimet tona natyrore?

Në këtë listë koncesionesh shihet që deti, toka, ajri, lumi janë dhënë me koncesione apo me PPP. Ju thatë që janë 220 kontrata totale nga të cilat 176 janë përpara 2013-s, diferenca 44 i bie të jetë pas 2013-s. A mund të themi një vlerë? Vërtet në numër janë pak kontrata, 44, por sa është vlera e këtyre kontratave, se ndonjëherë, sasia në numër kontratash

nuk do thotë domosdoshmërisht që të mos kenë vlerë të rëndësishme dhe të konsiderueshme në totalin e vlerave kontraktuale.

Arben Ahmetaj – Do të vini të pyetja?

Edlira Hyseni – Unë pyetje i kam këto.

Ju flisni për kontrata dhe koncesione aktive dhe të planifikuara, por këtu nuk bëhet dot një dallim cilat janë aktive dhe cilat planifikohen të bëhen, pra kemi të reja për vitin 2020, apo më tej, se këtu flitet për një kontratë për aeroportin e Kukësit? Pra që është ende në projekt.

Arben Ahmetaj – Jo nuk është në projekt ka kaluar edhe kontrata dhe për informacionin tuaj, në respekt të kuriozitetit dhe përgjegjshmërisë profesionale, pritet studimi aeronautik për t’u përcaktuar këndi i uljes së avionëve në pistën e Kukësit, për shkak të mjegullës dhe terrenit malor.

Edlira Hyseni – Vetëm kjo vështirësi ka penguar?

Arben Ahmetaj – Vetëm kjo.

Edlira Hyseni – Unë e vlerësoj kolegën Kushi që foli përpara, kam shumë respekt, dhe kryetarin. Lidhur me të rejat që ka sjellë kjo qeveri, dy i mbaj mend kurse për të tretën do të më falni. Një nga të elementet që ka sjellë qeveria sidomos me PPP-të, se këto janë më të diskutuarat, ishte përfshirja e rëndësishme e Ministrisë së Financave në këto projekte të reja PPP.

Tani kam një pyetje që e kemi përmendur edhe në seancë plenare. Në dy projektet e fundit që u miratuan, ishte Milot-Balldren dhe Orikum-Dukat, a ishte Ministria e Financave e përfshirë në analizat e saj teknike dhe financiare? Pra, a është Ministria e Financave në ato dy raste palë e rëndësishme dhe e bindur në vlerën e atyre dy projekteve tashmë të miratuara, por që mbeten ende fort në debatin publik, meqenëse thamë që roli i Ministrisë së Financave është rritur, apo ato dy projekte kanë qenë një vendimmarrje e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ministrisë së Financave mund të ketë dhënë vetëm një miratim në parim, por jo në vlera? A jeni ju, si Ministri e Financave e bindur për vlerën e dy PPP-ve, Milot-Balldren dhe Orikum-Dukat, apo keni dhënë një gjykim dhe vlerësim në parim dhe ende sot nuk keni një konstatim, apo preventiv tuajin?

Arben Ahmetaj – Pyetja ishte e drejtë, por kur i thoni që ishit palë...ligji nuk ka definicion të qenit palë, ligji ka definicion autoritet kontraktor dhe autoritet fiskal, si dhe procedurë të përcaktuar. Edhe pyetja “apo juve nuk...” është pak provokuese, por gjithsesi ministrja e përballon provokimin tuaj, kështu që nuk ka problem.

Edlira Hyseni – Ju e thatë në fillim të fjalës suaj më duket, por nuk e mbaj mend, prandaj kërkoj ndjesë! A ka projekte të reja për 2020-n të parashikuara të PPP-ve me, ose pa ofertë të pakërkuar, flas për projekte në proces, që ende nuk janë miratuar, por që parashikohen të kalojnë së shpejti për miratim? Oferta e pakërkuar ekziston, vetëm se nuk është për sistemin rrugor, por do të jetë për porte, aeroporte, etj. Vendimmarrja që PPP-të të kalojnë me ligj në parlament është shumë e mirë. Me këtë rast ju pyes a është bërë për më shumë transparencë dhe përfshirje e të gjithëve në këtë proces të rëndësishëm, apo është bërë për t'ia deleguar përgjegjësinë Kuvendit lidhur me miratimin e PPP-ve me ligj?

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, a mund t'u përgjigjeni 7 pyetjeve?

Anila Denaj – Së pari, të gjitha kontratat që janë në aneks, përfshirë edhe kontratat që nuk kanë mbështetje buxhetore, por janë kontrata koncesionare, që janë në fushën e energjisë, janë kontrata aktive dhe në aneks janë të gjitha vlerat e tyre.

Unë do të citoj raportin, të cilin e kemi të punuar si draft. Në respekt të pyetjes suaj se si është e shpërndarë shuma e investimeve jo thjesht në numër, por edhe në vlera sipas sektorëve, më lejoni të them se janë 14 kontrata, që mbajnë vlerë buxhetore dhe në vitin 2020 kjo vlerë, në total të 14 kontratave, është 14 miliardë lekë, ose 3,3%. Ndërkohë në kontekst vlerë-investimi, për të gjithë sektorët, duke filluar nga sektori i energjetikës e me radhë, 2 janë shifrat që do të përmend: numri i kontratave në totalin e 220-s dhe vlefata e investimit. Energjetika 186 kontrata me vlerë totale investimi, mjedisi 6 kontrata me vlerë investimi 25,8 miliardë lekë, shëndetësia 4 kontrata me 4,1 miliardë lekë, dhe këto janë 4 kontrata me mbështetje buxhetore dhe kontrata shërbimi, sektori i transportit 17 kontrata me vlerë totale investimi 67,5 miliardë lekë plus 9 kontrata të tjera për fusha të tjera. Roli që ka Ministria e Financave prej 1 tetorit është i përcaktuar në ligj dhe prej dhjetorit nuk ka, në dijeninë time, një kontratë që po shqyrtohet. A do të ketë kontrata, që brenda ligjit, të kërkuara apo jo, në proces, këtë nuk e përjashton askush, por në diskutimin e sotëm nuk ka asnjë kontratë.

Ndërkohë çdo kontratë përpara këtij ligji ka ndjekur të njëjtën rrugë procedurale që u theksua pak më parë dhe Ministria e Financave jep opinionin e saj në kontekstin e risqeve fiskale që sjell kjo kontratë, qëndrueshmërinë dhe përballueshmërinë e mbi të gjitha efektin që krijon në raport me tavanin buxhetor të përcaktuar. Në çdo kontratë, e cila ka mbështetje buxhetore dhe ka kaluar përpara datës 1 tetor, ka luajtur të njëjtin rol me të njëjtin fokus të tri elementeve që përmenda pak më lart.

Pse aprovohet në parlament? Sepse kjo është një ndarje përgjegjësisë. Më lejoni të abstenoj, pasi nuk më duket e drejtë që të kthej përgjigje për këtë! Këtu të gjithë janë me përgjegjësitë e veta dhe secili ka rolin e vet dhe është një rol i shtuar si një angazhim për të

respektuar kontratat në të gjithë vleftën e tyre, për të mos u përballur me probleme të panevojshme.

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, a mund të jap një sqarim në lidhje me ardhjen në Kuvend. Ardhja në Kuvend nuk përjashton askënd nga përgjegjësia, ardhja në Kuvend e një kontrate koncesionare, apo PPP-je, nuk i heq përgjegjësinë autoritetit kontraktor për atë analizë që ka bërë në dokumentet e veta, madje në procedurën ligjore nuk përfshihet fare. Është bërë një vendim qeverie për t'i dhënë të drejtë qeverisë që ta sjellë kur e gjykon ajo dhe kur e kërkon investitori. Elementi kryesor është transparenca, pra arsyeja pse janë sjellë këtu është transparenca.

Keni pyetjen e fundit?

Po, ju lutem!

Edlira Hyseni – Kam edhe një pyetje që është e lidhur me argumentin, por ju e përmendët më përpara. Zonja Ministre, ju thatë që për nevojat e rialokimit të buxhetit apo për ato nevoja që shpjeguat dhe të ardhurat, janë ngrirë një sërë projektesh kryesisht të Ministrisë së Infrastrukturës. Këtë ngrirje e përcaktoni duke vlerësuar projektet nëse janë apo jo produktive. Nuk e di nëse është një gjykim subjektiv apo objektiv, por pyetja ime është: kush vendos për ngrirjen e fondeve të projektit “x” apo “y” për shkak se konsiderohen jo produktive? Kjo është një vendimmarrje juaja për 1 milion arsye, por ndërkohë penalizoni punën e atyre që vazhdojnë të punojnë dhe nga ngrirja e fondeve ata kanë kosto. Pra, a informohen në kohë subjektet për këtë ngrirje fondesh dhe për kostot që do të kenë nga vendimmarrja juaj e brendshme, shpresoj objektive dhe jo subjektive? Këto projekte që u ngrihen fondet lidhen me kontratat koncesionare, PPP, apo edhe me investime të tjera jashtë fushës që po flasim?

Faleminderit!

Anila Denaj – Më lejoni të saktësoj një terminologji, produktiviteti nuk ka të bëjë me elementin e ngrirjes, ndërsa ecuria e projektit po. Ecuria e projektit është një tregues për mos futjen në konflikt, pra projektet që nuk kanë ecur mirë në zbatimin e tyre nuk mund të krijojnë konflikte në rastin e ngrirjes, për arsye të një kuadri makrofiskal të ruajtur. Pra, është shumë e nevojshme që ta kemi të qartë që në një kontratë, e cila ka produktivitetin e saj, në pyetjen që zoti Rroshi bëri në fillim, nuk ka lidhje me ngrirjen.

Informacioni bëhet në bazë të një komunikimi, si në komitetet tona ndërmministrore, ashtu dhe me palët kontraktore. Por siç e thashë pak më përpara, janë kontrata ku ecuria ka qenë shumë e ngadaltë dhe detyrimisht që të mos rrezikohet, vendoset një proces ngadalësimi

i mëtejshëm deri në momentin që të jemi të qartë në zbatimin e parametrave dhe treguesve fiskalë deri në fund të vitit.

Arben Ahmetaj – Po, zonja Suzana.

Suzana Topi – Faleminderit!

Në funksion të mjekësisë falas, po flas sterilizimin dhe për *check up*-in e analizave, a kanë dhënë efekte në rritjen e shërbimit ndaj qytetarëve këto dy koncesione, sepse, me sa di unë, shqiptarët po paguajnë më shumë duke iu drejtuar spitaleve private ngaqë analizat e bëra aty nuk dalin mirë?

Arben Ahmetaj – Po, zonja Ministre.

Anila Denaj – Do të më duhet të saktësoj tre terminologji. *Check up*-i është një kontratë që ka një objektiv shumë të rëndësishëm, atë të parandalimit të sëmundjeve, duke i evidentuar ato në kohë dhe në efekte afatmesëm të uljes së kostove të shërbimit. Pra, duke e evidentuar më herët ke mundësi ta mjekosh në fazat e para dhe të kesh më pak kosto në të ardhmen, si nga buxheti i shtetit, nëse do të kishte ndonjë kontratë të lidhur me të apo në raport me listën e barnave, të cilat janë pjesë e zërave buxhetorë të Ministrisë së Shëndetësisë. Në raport me *check up*-in dhe tavanet e vendosura për vizitat, është tejkaluar niveli 100% të marrë në angazhim në këtë kontratë. Pra është një kontratë që po ecën mirë dhe që ndërgjegjësimi në popullsi e ka arritur qëllimin.

Arben Ahmetaj – Përpara se të kaloni diku tjetër, a ka një përlllogaritje të Ministrisë së Shëndetësisë duke iu referuar metodologjisë së *National Institut of Help* në Britani? Unë e kam paraqitur edhe herën e kaluar në Kuvend, nëse e keni, ta ndani me deputetët që nuk kanë qenë këtu vitin e kaluar, në dhjetor për ta dëgjuar. Pra, të ndani atë kalkulim që kemi bërë për sa i përket parandalimit, shpëtimit të jetëve dhe kostove ndër vite. Kjo është shumë interesante dhe do t'i ndihmonte deputetët, por edhe deputeten që bëri pyetjen, që të qartësohen në lidhje me *check up*-in, të cilit unë i referohem shumë shpesh politikisht me shprehjen “jeta nuk ka çmim”, pra ndihma për jetën nuk ka çmim.

Anila Denaj – Kur flasim për tavanet në kontratën e *check up*-it, në kuadër të asaj që nuk ka çmim, në vlerën e koncesionit në vit, pra në vitin që jemi, është në nivelin e 657 milionë lekë. Kontrolli bazë i popullsisë nga mosha 35 deri në 70 vjeç redukton jo vetëm sëmundshmërinë në të ardhmen, por edhe përqindjen e një treguesi tjetër, që në terminologjinë e shëndetësisë quhet *out of pocket money*, ku ky tregues vjen i ulur sa më shumë ulet baza e kontrollit paraprak.

Dy elemente të tjera shumë të rëndësishme, përveç *check up*-it, si element parandalues, në terminologjinë tuaj ju përmendët sterilizimin dhe analizat. Më lejoni të

theksoj se analizat janë një kontratë koncesionare që zbatimin e saj e fillon vitin tjetër, ndërsa sterilizimi është një kontratë koncesionare koherente. Ne besojmë që i gjithë niveli i ndërhyrjeve mjekësore, që sot sigurohen me një kuadër sterilizimi brenda një niveli shumë më të apdetuar, sot është fakt në shëndetësi, kundrejt kostos së saj në buxhet. Ndërsa analizat janë një projekt i vitit 2020 me një kosto prej 1,2 miliardë lekësh. Pra janë tre elemente të ndryshme dhe të tria bashkë bëjnë koston e përmendur më lart prej 4,1 miliardë lekësh.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Pyetja e fundit nga zoti Vullnet.

Vullnet Sinaj – Faleminderit, kryetar!

PPP-të janë bërë sikur janë një e keqe në ekonomi. Për mendimin tim, kjo është një marrëdhënie shumë e mirë, ku shteti apo qeveria bën thirrje për të zhvilluar sektorë të ndryshëm të ekonomisë me biznesin privat dhe nga ana tjetër qeveria hyn me një risk shumë të vogël, që sipas ligjit nr. 936 lejohet që pagesa, që do të bëhen për koncesionet dhe për marrëdhëniet me partneritetet publik privat, është jo më e madhe se 5% e të ardhurave tatimore faktike të një viti më parë. Pra, të ndërtosh ekonominë e vendit duke pasur risk zero, sepse 5% e të ardhurave të një viti më parë të tatimeve është shumë e vogël, dua të them se nuk ka vend për të diskutuar dhe për të dezinformuar publikun. Kjo është një largpamësi e qeverisë “Rama” dhe është një nga veprimet më të zgjuara që ka bërë për të zhvilluar ekonominë e vendit, duke tërhequr kapitalet e biznesit privat brenda.

Zonja Ministre, unë kam një pyetje për 5% që është lejuar, dua të kuptoj pse është caktuar 5 %? Mbase kjo pyetje nuk është për ty, sepse kjo vjen e trashëguar nga ligji dhe ju jeni e detyruar të zbatoni ligjin, por e bëj për të kuptuar pse është caktuar 5%. Unë e shikoj që ligji është i vitit 2008, mos ndoshta duhet shtuar? Opozita thotë ta pakësojmë, ndërsa unë them ta shtojmë aktivitetin me partneritetin publik privat.

Edhe një gjë tjetër, 5% e të ardhurave faktike të një viti më parë, dua të di çfarë futet në këto të ardhura tatimore të një viti më parë? Kjo është vlerë e barabartë me të ardhurat që vijnë në buxhet apo është më e vogël? Pra çfarë futet këtu, të ardhurat nga doganat apo të gjitha të ardhurat?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zonja Ministre.

Anila Denaj – Ligji është i vitit 2016. Në gjykimin tonë ky është një tavan që duhet të maturohet në këtë përqindje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di mbase duhet ta verifikojmë. Unë nuk sugjeroj që të lëvizet tavanin 5%. Ky është një tavan që duhet kohë për t'u maturuar dhe për ta gjykuar, nëse duhet të lëvizet. Siç e thashë edhe më përpara ne kemi një hapësirë për tavanin, për çdo risk fiskal që mund të ndodhë, si në raport me realizimin e të ardhurave në një vit të caktuar, ashtu edhe në raport me konservatorizmin që duhet të ruajmë.

Në raport me të ardhurat, unë besoj se të gjithë të ardhurat, të cilat janë tatimore, përfshirë edhe doganat, janë të përfshira në të. Nuk sugjerojmë heqjen e tavanit edhe në vitet në vijim. Unë si ministre nuk e sugjeroj.

Arben Ahmetaj – Zoti Vullnet, unë që e kam iniciuar tavanin, nuk do të votoja kurrë të hiqej tavanin. Pra një ministre dhe një ish-ministër që nuk do ta aprovojnë heqjen e tavanit, për shkak se është një raport i shëndetshëm dhe me investimet e tjera publike ka një koncept në teknikën e financave publike që quhet: mbipopullimi në një kohë të caktuar i investimeve publike. Nëse e rrisim tavanin, i bie që do të nxjerrim jashtë investimet e tjera publike koherente apo në planifikim.

Zonja Ministre, faleminderit!

Pyetja e fundit, ju lutem sa më konciz.

Krenar Ryci – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre, që jeni këtu!

Unë nuk dua të përsëris kolegët deputetë dhe jam dakord me shqetësimet e tyre, por kam një merak në lidhje me segmentin rrugor Thumanë – Rrogozhinë, i cili ka qenë një nga prioritetet e kësaj qeverie, ajo rrugë sa u fillua, por nuk u mbarua. Unë dua të di a është në prioritetet tuaja për vitin 2020, sepse, me sa pashë, në listë nuk ndodhet? Kur mendoni që kjo rrugë do të fillojë punimet përsëri, meqenëse ne e parashikojmë si domosdoshmëri, sepse është një rrugë që lidh Veriun dhe Jugun?

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, ju lutem, shkurt.

Anila Denaj – Në kontratat e vendosura përpara jush për informacion, kjo rrugë nuk është. Nëse do të jetë në prioritet, për procedura kjo i takon Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës për të dhënë një përgjigje.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Falënderoj zonjën ministre dhe stafin e saj për prezencën dhe për përgjigjet! Unë dua me shkrim një për një kontratat, detyrimet ligjore kontraktuale dhe furnizimi i tyre me financim gjatë viteve 2019 – 2020. Kontratat, të cilat bien në llogari kapitale dhe në llogarinë koherente, shpenzimet operative 602.

Mbledhja mbyllet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti